



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.06.2019 ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 30 maj dhe 10 qershor 2019
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2018 për projektin “Programi sektorial i ujërave/furnizimi me ujë i zonave rurale IV”.

Marrin pjesë: Mimi Kodheli, Ditmir Bushati, Eglantina Gjermeni, Evis Kushi, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Andrea Marto, Adnor Shameti, Elona Hoxha, Ervin Bushati, Alket Hyseni, Vasilika Hysi, Xhemal Qefalia, Ligoraq Karamelo dhe Rudina Hajdari

Mungon: Reme Lala

Të ftuar

Hantin Bonati – Zëvendësministër i Energjisë dhe Infrastrukturës

Lindita Sotiri – Drejtoreshë në Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës

Jovan Gjika – Koordinator i Projektit (Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve)

Leonard Miloti – Koordinator i Projektit (Fondi Shqiptar i Zhvillimit)

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme, datë 20 qershor 2019. Në rend të ditës kemi miratimin e procesverbaleve të datave 30 maj dhe 10 qershor dhe më pas diskutimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2018 për projektin “Programi sektorial i ujërave/furnizimi me ujë i zonave rurale IV”.

Për të diskutuar për këtë projektligj kemi të ftuar zotin Bonati, zëvendësministër i Energjisë dhe Infrastrukturës, zonjën Sotiri, drejtoreshë në këtë ministri, zotin Gjika, koordinator projekti dhe zotin Miloti, i cili është gjithashtu koordinator projekti. Mirë se vini!

A ka ndonjë vërejtje për procesverbalet e datave 30 maj dhe 10 qershor? Nuk ka.

Miratohe.

Kalojmë në diskutimin e projektligjit.

Zoti Bonati, ju lutem, na thoni dy fjalë shteruese lidhur me marrëveshjen e re mes Republikës së Shqipërisë dhe asaj Federale të Gjermanisë për këtë projekt.

Fjala për ju.

Hantini Bonati – Faleminderit!

Sikurse e thatë edhe ju, ky projektligj synon ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar për vitin 2018. Ky projekt është për zonat rurale nr. 4 dhe synimi është që të parashikohet nga KfW-ja akordimi i një kredie të butë në vlerën 40 milionë euro dhe i një granti me vlerë 2 milionë euro.

Në fokus të këtij projekti është çështja mjaft problematike e furnizimit me ujë të zonës së Himarës dhe zonës së Orikumit. Investimet e fundit që janë bërë në këto zona i përkasin vitit 1964.

Nëpërmjet këtij projekti synohet të gjejnë zgjidhje të përhershme me furnizimin me ujë Bashkia Himarë, ku futet qyteti i Himarës, fshatrat Kuç, Buronjë, Pilur, Kullës, Vuno, Jalë, Livadh, Himarë fshat, Qeparo dhe Borsh. Gjithashtu, do të bëhet edhe impianti për trajtimin e ujërave të ndotura në Himarë dhe Orikum. Përfitues të këtij projekti do të jenë 53 mijë banorët e Himarës dhe 36 mijë banorët e Orikumit.

Aktualisht ka mbaruar studimi i fizibilitetit për projektin dhe, sipas parashikimeve që janë bërë, dizajni përfundon në maj të vitit 2020 dhe fillimi i punimeve nis në shtator të vitit 2020.

Synimet janë që brenda vitit 2021 Orikumi dhe e Himara së bashku me fshatrat të kenë 24 orë furnizim me ujë. Brenda vitit 2022 të vihet në funksion të plotë impianti i trajtimit të ujërave të zeza në Himarë dhe brenda vitit 2021 të vihet në funksion impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në Orikum. Pra kjo situatë që është mjaft problematike në këto zona, të cilat janë tepër të frekuentuara për turizëm do të zgjidhet.

Në këtë rast agjencia zbatuese është Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe ne jemi këtu si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për sektorin e furnizimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

A ka pyetje?

Ligoraq Karamelo – Kisha një diskutim.

Mimi Kodheli – Të mbarojmë me pyetjet, pastaj kalojmë në diskutime.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Karamelo, ju lutem!

Para se të kalojmë te pyetjet dhe te diskutimet, meqenëse po flasim për një projekt të ri dhe zonja Gjermani është relatore, dëshiroj t'i jap fjalën të fillojë diskutimin e sotëm.

Më pas do të vijojmë me përmbledhjen e pyetjeve dhe të diskutimeve.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zonja kryetare!

E vlerësoj maksimalisht faktin që, më në fund, për dy zona kaq të rëndësishme të turizmit në Shqipëri do të ketë një projekt investimi nga Republika e Gjermanisë për ujësjellësin dhe për ujin e pijshëm 24 orë. Besoj se zëvendësministri dha një shpjegim ezaurues për këtë marrëveshje.

Do të doja të përfitoja nga rasti dhe të falënderoja në mënyrë të veçantë Republikën Federale të Gjermanisë, e cila ndër vite ka dhënë dhe vazhdon të japë një kontribut të rëndësishëm, sidomos në fushën e ujësjellës-kanalizimeve! Fakti që ujësjellësi ekzistues është kaq i amortizuar, sepse ndërhyrja e fundit ka qenë në vitin 1964, siç ju thatë, e bën edhe më imediate këtë ndërhyrje. Më vjen shumë mirë që nga ky investim i rëndësishëm do të përfitojnë jo vetëm qytetarët, por edhe turistët. Unë dua të di vetëm afatet kohore, kur fillon dhe kur mbaron, meqenëse studimi i fizibilitetit ka përfunduar. Kur do të përfundojë ujësjellësi dhe kur do të ketë ujë të pijshëm 24 orë? Ndërkohë, ju e thatë se janë gati 80 mijë

banorë, por nëse shtojmë edhe numrin e turistëve, atëherë numri i përfutësve rritet edhe më shumë. Besoj se kjo do të ketë një impakt të jashtëzakonshëm për zhvillimin e turizmit.

Unë ju ftoj të gjithëve ta votojmë, sepse besoj se është një kontribut më shumë për një zhvillim të qëndrueshëm dhe, për më tepër, për përmirësimin e kushteve të jetesës së të gjithë qytetarëve!

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Dëshiroj të shpreh mirënjohje të madhe për KfW-në dhe për Republikën Federale të Gjermanisë, që kanë investuar mbi 1 miliard euro, duke qenë investitorët më të mëdhenj, për distanca të madha dhe sidomos për projekte të zhvillimit dhe të promovimit të ekonomisë. Gjithashtu, më vjen shumë mirë që bëhet investim për këto dy zona dhe sugjeroj të shikohet, të promovohet dhe në kontratë të thuhet: “zonave turistike” jo thjesht rurale, për disa arsye.

E para, ne kemi 61 bashki dhe “zona rurale” nuk ka më vlerë. Tashmë termi është zona administrative. Unë jam shumë dakord të promovohen zonat turistike. Ne i kemi të gjithë votues dhe duhet të jemi të ndjeshëm ndaj tyre, por mendoj se duhet të ketë më shumë investime në zonat turistike dhe të jenë promotorë për disa arsye: jo vetëm se paguajnë më shumë taksa dhe zhvillohet ekonomia, por mund të jenë pasqyra më e mirë e Shqipërisë me të huajt. Kjo do të ndikojë që edhe bashki të tjera më të vogla të fillojnë të orientohen drejt turizmit dhe pak a shumë, e gjithë Shqipëria të mund të jetojë me turizëm. Në Shqipëri ka zona turistike malore dhe bregdetare dhe të gjitha zonave do t’u interesonte kjo. Po ashtu, kemi edhe një status të veçantë, që investimet turistike mund të shikohen edhe me efekte financiare, të promovohen ndryshe nga qeveria në taksim, në TVSH e të tjera. Në këtë pikë, duhet të shikohet edhe në kontratë, edhe në kuadrin ligjor për më gjerë, që të promovohen, por edhe të tjerët të fillojnë të shohin nga këto zona turistike. Le të quhen investime të pastra turistike dhe të mos kemi më kompleksin që, meqë është rurale, duhet ndihmuar. Ato janë zona turistike, të cilat punojnë, por mund të punojnë edhe më mirë, sepse këto kthehen në më shumë lekë me të ardhura, aq më tepër që termi është i tejkaluar.

Kaq kisha.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Bushati!

Të nderuar kolegë, unë mendoj që të merren të gjitha pyetjet e kolegëve të tjerë, edhe të ministres Gjermani, pastaj të përgjigjeni.

Zoti Karamelo, fjala për ju.

Ligoraq Karamelo – Edhe unë do të falënderoja, në radhë të parë, qeverinë gjermane për këtë investim shumë të rëndësishëm, por kuptohet që promotore në këtë mes është qeveria shqiptare dhe meriton përgëzime për prioritetin që u jep zonës bregdetare dhe turizmit, pavarësisht se për ne është një shans më shumë, pasi ajo është një zonë mjaft e ndjeshme dhe e prekshme, ku banon një pjesë e minoritetit grek dhe ka mjaft probleme të tjera, që besoj se do të ndikojnë shumë në përmirësimin e klimës së bashkëjetesës së komunitetit dhe në zhvillimin e mëtejshëm të zonës.

Nga ana tjetër, unë kisha një pyetje për të sqaruar. Në materialin që na është paraqitur thuhet se përcaktimi përfundimtar se ku do të jenë investimet në Himarë do të bëhet më vonë, pra do t'i nënshtrohen një herë studimit të fizibilitetit. A janë nënshtruar, apo do t'i nënshtrohen? Në kuadrin e kësaj, do të thosha që të shihej mundësia për të zgjidhur të gjitha problemet e bregdetit, domethënë të shkonte deri te pjesa e Lukovës, sepse mund të bëhet një tip diferencimi, që do të krijonte probleme në atë zonë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Karamelo!

Fjala për ju, zoti Miloti.

Jovan Gjika – Për sa i përket pyetjes lidhur me afatin se kur do të bëhet e mundur, po ju them se studimet e fizibilitetit kanë përfunduar, për Himarën kanë përfunduar në tetor, kurse për Orikumin në maj. Procesi i prokurimit për dizajnin dhe mbikëqyrjen përfundon brenda muajit maj të vitit 2020, fillimi i punimeve sipas grafikut parashikohet për në muajin shtator të vitit 2020, kurse vënia në funksionim është për disa komponentë. Instalimi i ujit të pijshëm përfundon brenda vitit 2021, trajtimi i ujërave të ndotura urbane për Himarën përfundon brenda vitit 2022, pasi është diçka tërësisht për t'u bërë, se nuk ekziston fare, ndërkohë, për të vënë në funksion impiantin e trajtimit të ujërave të zeza urbane për Orikumin është caktuar viti 2021. Këto janë afatet që ne do të përpiqemi t'i realizojmë, pasi fondet janë në dispozicion, projektet janë të qarta dhe mbështetja nga qeveria gjermane është shumë e rëndësishme për ne, me qëllim që ky projekt të realizohet sipas grafikut dhe parashikimit tonë.

Për sa i përket pyetjes së zotit Bushati në lidhje me emrin, edhe ne si ministri kemi kërkuar që termi të ndryshojë, por qeveria gjermane dhe KfW-ja, për arsye e tyre procedurale që u duhej të ndërronin shumë dokumente, sepse ka qenë një term i parashikuar të marrëveshjet e mëparshme, nuk e ndryshonin dot dhe ka ngelur me të njëjtën terminologji. Më përpara këto terminologji shërbenin për ndarjen, që do të thotë se për agjencitë zbatuese

për zonat rurale ka qenë Fondi Shqiptar i Zhvillimit, kurse për të tjerat ka qenë kjo. Zonat turistike janë një nga 5 prioritetet e qeverisë dhe në gjatë këtij mandati jemi munduar, sidomos zonat bregdetare, t'i akomodojmë nëpërmjet bashkëpunimit me KfW-në. E gjithë zona e bregdetit është e mbuluar me investime, duke filluar nga Saranda, Vlora, Fieri (Durrësin e ka Banka Botërore), Lezha dhe Velipoja. Pra, është në prioritetin tonë dhe ne do të kemi mbështetjen e KfW-së. Këtu po flasim vetëm për një komponent, por ajo është në fokusin tonë dhe investimet që parashikohen nga buxheti i shtetit do të jenë për zona turistike.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Në fakt, zoti Miloti bëtë shumë mirë që na i kujtuat që investimet e fundit në këtë rrjet janë bërë në vitin '64 dhe tani janë konsumuar të gjitha. Jam dakord me atë që tha deputeti Bushati, që nuk duhet të quhen rurale. Unë kam vetëm një pyetje. Flitet për fshatrat sipër apo fshatrat sipër dhe investimet poshtë? Janë dy gjëra pak të ndryshme.

Jovan Gjika – Termi “rurale” nuk u pranua nga pala gjermane të ndryshohej terminologjia për shkak të procedurave burokratike, kurse gjithë të tjerat janë quajtur “programet rurale”.

Mimi Kodheli – Është e njëjta terminologji.

Jovan Gjika – Për sa u përket investimeve, në bashkinë e Himarës futen qyteti i Himarës, fshatrat: Kuçi, nga është edhe burimi, Piluri Kudhësi, Vunoi, Jali, Livadhi, Himara fshat, Qeparoi dhe Borshi.

Mimi Kodheli – Po pra, se Qeparoi është sipër dhe poshtë, Himara është edhe lart, edhe poshtë, Vunoi është lart dhe poshtë.

Me investimet e reja të firmave që financojnë fshatrat turistikë në buzë të detit, si i kemi punët? Dikur, për shkak të gropave septike, largimi i ujërave të zeza është bërë jo me impiant, por në mënyrë natyrale dhe përsëri deti ka qenë i pastër (aq sa e konceptonte një njeri i vitit '64 kur shkonte në plazh).

Sot ndotja vjen më së shumti nga investimet në bregdet dhe jo nga ata që banojnë akoma sipër në fshat. Kush banon në fshat sipër ose ka ikur ose i funksionon gropa septike akoma. Jam e saktë në këtë perceptim?

Ka një *network* të ri sot që janë ndërtuar fshatra turistikë në buzë të detit?

(Diskutime pa mikrofon)

Janë të gjitha me gropa septike.

Jovan Gjika – Ministria e Mjedisit, përpara se të japë lejen mjedisore, ai mund të ketë edhe impiante ...

Mimi Kodheli – Pra, ai nuk mund ta fillojë ta ndërtojë nëse nuk ka impiante burimi.

Jovan Gjika – Në Palasë, te Green Coast është financuar nga buxheti i shtetit impianti i ujërave të zeza, që mbledh edhe pjesën e Drimadhes.

Mimi Kodheli – Pra, në këtë rast, ky investim i atashohet, këto dalin jashtë përdorimit, shfrytëzohen, ...?

Jovan Gjika – Jashtë përdorimit dalin vetëm të vjetra. Këto integrohen.

Mimi Kodheli – Pra, në projekt e keni edhe integrimin.

Jovan Gjika – Po, patjetër. Burimi i Kuçit ka sasi të mëdha uji. Ky quhet biznes rajonal, pra për disa fshatra. Prandaj është zgjedhur ky burim. Sot ka burime të vogla dhe fshatrat marrin ujë, por ai është burim me prurje të madhe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ditmir Bushati – Pse u bë në Palasë, kur shumica e njerëzve janë në Dhërmi apo Drimadhes?

Jovan Gjika – Impianti?

Ditmir Bushati – Po.

Impianti është bërë për këtë zonë. Nuk mund t'i sjellësh nga Dhërmiu këtu. Këto janë zgjidhje lokale, nuk mund të bësh një qendror për të gjithë bregun.

Ditmir Bushati – Po pjesa tjetër e Dhërmiut apo Drimadhesit, e ka?

Jovan Gjika – Kjo pjesë e Drimadhesit e sjell këtu.

Ditmir Bushati – Po e Dhërmiut?

Jovan Gjika – Ka rezidenca qeveritare dhe andej duhet një zgjidhje tjetër, se nuk mund t'i sjellësh në një vend.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Kam edhe diçka tjetër, meqë jemi në bregdet. Saranda e ka burimin aty dhe për një mungesë investimi, për një minimum infrastrukture, qyteti vazhdon të mbetet pa ujë. Jam e saktë, zoti Miloti?

Jovan Gjika – 60% e qytetit të Sarandës. Pra, gjithë zona e qytetit nën kuotën e Rrugës së Pestë ka rrjet të ri, që prej 2 vjetësh, i bërë nga KfW-ja dhe ka ujë 24 orë.

Mimi Kodheli – 60%.

Jovan Gjika – Është kuota e Rrugës së Pestë e poshtë, deri në bregdet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pjesa e qytetit mbi këtë kuotë, ka pasur një investim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

T'jua shpjegoj me kuotë, që të orientohe mi të gjithë, se kështu me zona pak e vështirë. Është bërë pjesërisht vetëm linja e transmetimit nga Qafë-Gjashta deri te Lugu i Dardhës. Pjesa tjetër është në proces. Tani jemi në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

Mimi Kodheli – Pikërisht për këtë pyeta.

Jovan Gjika - ...për të bërë rrjetin e shpërndarjes së kësaj zone, që quhet Lugu i Dardhës dhe shkon përtej portit.

Mimi Kodheli – Pra, ai është investimi.

Jovan Gjika – Te programi i infrastrukturës bashkiake, që kemi iniciuar me KfW-në fazën e pestë, kjo zonë është e përfshirë, por edhe zona e Gjashtës, që është një zonë informale, si dhe të gjitha zonat turistike, duke kaluar edhe përtej, duke përfshirë edhe fshatrat ku shkohet drejt Ksamilit, Çukën dhe Berdoneshin...

Eglantina Gjermani – Kam një pyetje (ju kërkoj ndjesë që nuk e bëra më parë): duke qenë se në këto zona realizohet edhe projekti i Bankës Botërore për zhvillimin e turizmit, a po ecën mirë projekti? A e plotësojnë njëri-tjetrin dhe me këtë pjesën e ujësjellësit, se ata kishin investime infrastrukturore për zhvillimin e turizmit. Vazhdon me Fondin Shqiptar të Zhvillimit apo jo?

Jovan Gjika – Projekti i Bankës Botërore është në Gjirokastrë, Përmet dhe në zona të tjera.

Eglantina Gjermani – Dakord.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Nëse nuk ka ndonjë gjë tjetër për të sqaruar, ju falënderoj!

Kalojmë në votim.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Votojmë në tërësi.

Kush është dakord? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Do të njoftoheni për mbledhjen tjetër.

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA